



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi

Mbledhja nr. 05

Prishtinë, më 15 shkurt 2010, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Në mbledhje morën pjesë: Bahri Hyseni - kryetar, Bajram Kosumi, Adem Hajdaraj, Selvije Halimi, Ramadan Gashi, Adem Salihaj, Vladimir Todoroviq, Armend Zemaj, Mufeta Şinik dhe Kolë Berisha.

Mungoi: Ibrahim Makolli.

Pjesëmarrës të tjerë: Lulzim Krapca, praktikant dhe Albulena Ademi, praktikante – NDI, Lejla Selimi – OSBE, Blerta Ulneta, Anan Robinson, Yordan Sirakov, Nathalia Berkowitz dhe Vlora Marmullakaj – EULEX, Besnik Boletini – Bota sot, Rrezarta Ahmeti – KDI, Petrit Hysaj - OSBE dhe Visar Krasniqi – Zyra e Komisioneve të Kuvendit.

Nga Stafi i Komisionit: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Sulltane Gashi.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky;

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 8 shkurtit 2010,
3. Shqyrtimi i përfundimit të Kryesisë së Kuvendit të Kosovës nr. 03-P-188 të datës 8 shkurt 2010, lidhur me propozimin e Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e një anëtari të Komisionit për kërkesat pronësore,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për mjekësinë ligjore me amendamentet e propozuara nga grupi i punës,
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 08 shkurtit 2010

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 08 shkurt 2010 pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i përfundimit të Kryesisë së Kuvendit të Kosovës nr. 03-P-188 të datës 8 shkurt 2010, lidhur me propozimin e Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e një anëtari të Komisionit për kërkesat pronësore

Kryetari - I njoftoi me përfundimin e kryesisë së Kuvendit lidhur me propozimin e Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës, lidhur me vazhdimin e mandatit anëtarit të Komisionit për pronën, të cilit i ka skaduar mandati, është i njëjti kandidat Adem Vokshi, i propozuar edhe për provimin e jurisprudencës. Propozoi që i njëjti të përkrahet, sepse nuk ka ndonjë pengesë që t'i vazhdohet mandati.

Armend Zemaj - Duke u ndërlidhur me parafolësin tha se e përkrah propozimin për vazhdimin e mandatit, mirëpo shprehu shqetësimin se është krijuar një shprehi dhe gjeneratave të reja nuk po u jepet përparësi. Në vazhdim tha se po kemi dyfishime të pozitive për kandidatet e caktuar, kurse ka mjaft persona nga gjeneratat e reja të cilët presin për një vend pune.

Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Të emërohet Adem Vokshi, anëtar i Komisionit për kërkesat pronësore.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për mjekësin ligjore me amendamentet e propozuara nga grupi i punës

Kryetari paraqiti Propozimamendamentet e grupit të punës, duke i njoftuar anëtarët edhe me rekomandimet e përfaqësuesve të EULEX- it, që i kanë paraqitur lidhur me Projektligjin e mjekësisë ligjore.

Përfaqësuesit e EULEK - sit propozuan që në nenin 5, në titull të shtohet “Afati për kryerjen e ekzaminimeve mjekoligjore dhe autopsive”.

Si rekomandim i tyre ishte që neni 11, paragrafi 6, të futet në nenin 5, paragrafi 4, ndërsa paragrafi 4 të fshihet.

Kjo sipas tyre është ngase po ndodhin shtyrje të panevojshme në përpilimin e raporteve të autopsive mjekoligjore.

Kryetari kërkoj deklarinimin e anëtareve rreth këtij propozimi, që të fshihet paragrafi 6, i nenit 11. Pasi nuk kishte vërejtje, i njëjti propozim u aprovua duke riformuluar nenin 5, paragrafi 3 ” *Të gjitha raportet mjekoligjore të autopsisë duhet të përfundohen dhe nënshkruhen 10 ditë pas pranimit të rezultateve laboratorike, kurse ato të ekzaminimeve klinike të përfundojnë brenda 3 ditëve*”.

Përfaqësuesit e EULEK- sit në nenin 6 kërkuar që të shikohet se shpenzimet e autopsive dhe ekzaminimeve momentalisht paguhet nga Ministria e Drejtësisë. Propozuan që të shikohet mundësia që të ndahen fonde në buxhetin e Departamentit të mjekësisë ligjore, brenda Ministrisë së Drejtësisë.

Kryetari duke u ndërlidhur me parafolësit tha se çdo lëvizje në këtë drejtim mund të sjellë problem, konsideroi se duhet të mbetet ashtu siç është në Projektligj.

Përfaqësuesit e EULEK - sit propozuan që në nenin 7, paragrafi 2 të jetë “ Informatat e parapara në paragrafin 1 i zbulon vetëm organi i cili e ka kërkuar ekzaminimin mjekoligjor ose autopsinë”.

Këtë propozim e përkrahën Selvije Halimi dhe Armend Zemaj.

Adem Hajdarej – Tha se riformuloj nenin 7, paragrafi 2 “ Zbulimi i informatave të parapara me paragrafin 1. të këtij neni mund të bëhet pas urdhrin të lëshuar nga gjykata kompetente”.

Përfaqësuesit e EULEK - sit propozuan që në nenin 8, në titull të shtohet “ autopsitë mjekoligjore”.

Kryetari e përkrahu propozimin edhe riformuloj “ Detyrimet e Organeve Hetimore dhe Gjyqësore për Autopsinë Mjekoligjore “.

Selvije Halimi- Tha se mjekësia e njeh trupin, nuk e njeh pjesën mortore, p.sh dorën si pjesë e trupit.

Ramadan Gashi- Tha se duhet të shikohen versionet në gjuhën angleze dhe serbe dhe propozoi që të riformulohet “ *Pasi që autopsia të kryhet, trupi i vdekur ose pjesët e trupit u kthehen anëtareve të familjes* “ teksti vazhdon si në Projektligj.

Kryetari, pas propozimeve të dala riformuloj nenin 10.1 “ *Pasi që autopsia të kryhet, trupi i vdekur i identifikuar, pjesët e trupit dhe mbetjet mortore u kthehen anëtareve të familjes, në rast se nuk ekziston nevoja për ekzaminime të mëtutjeshme mjekoligjore* “.

Në vazhdim kërkoj sqarim nga ekspertët lidhur me nenin 11. paragrafi 1, lidhur me përcaktimin e karakterit të mjetit, ceku se mjetet kanë karakteristikë, jo karakter. Me sqarimet e ofruara nenin 11, paragrafi 1.1, në vend të fjalës “**karakterin** “ bëhet“ karakteristikat “.

U diskutua neni 11, paragrafi 1.3, pati propozime, si nga ana e ekspertëve të EULEX – it, po ashtu edhe nga anëtarët e Komisionit. Pas diskutimit të zhvilluar ishte konstatim i përgjithshëm të riformulohet “ *Për përcaktimin e gjendjes seksuale dhe ekzaminimet mjekoligjore të personit që është viktimë e veprës penale kundër integritetit seksual*”.

Kishte propozime nga përfaqësuesit e EULEX - it edhe në nenin 11, paragrafi 3, për marrjen e pëlqimit me shkrim nga pacienti për ekzaminim.

Kryetari lidhur me këtë propozim afroq sqarim duke thënë se ligj bazik është Kodi Procedurës Penale, i cili parasheh që në momentin e refuzimit nga personi që t'i nënshtrohet ekzaminimit, atëherë kryhet me urdhër të gjykatës.

Pas propozimeve të dala Komisioni vendosi që në nenin 11, paragrafi 3, të shtohet “ *Në rast të refuzimit pa arsye vlejshme dispozitat e Kodit të Procedurës Penale* ”.

Ishte propozim i përfaqësuesit të EULEX - it që në nenin 14, paragrafi 1, të riformulohet “ *Personeli i departamentit të mjekësisë ligjore nuk do të kalojë më shumë se 6 orë në procesin e autopsisë dhe ekzaminimeve të tjera*”.

Kryetari lidhur me propozimin e afuar në nenin 14, paragrafi 1, tha se do të marrim një qëndrim të ekspertëve dhe të zyrtarëve ligjor lidhur me këtë propozim.

Kryetari konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime, nxori këtë:

PËRFUNDIM

Miratohen amendamentet e grupit të punës me plotësimet e dhëna dhe procedohen për shqyrtim të mëtejshëm në Komisionet e tjera funksionale.

5. Të ndryshme

a. Shqyrtimi i bazës juridike të Projektligjeve

Komisioni e shqyrtoi bazën juridike të projektligjeve:
Projektligjit për Klasifikimin e Informatave dhe Verifikimin e Sigurisë dhe
Projektligjin për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës.

Komisioni vlerësoi se projektligjet kanë bazë juridike në pajtim me nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

b. Njoftim me listën e propozuar të ekspertëve

Kryetari i njoftoi anëtarët se administrata ka bërë një listë shtesë të ekspertëve. Ne, si Komision, do ta shqyrtojmë në mbledhjen e radhës.

Mbledhja përfundoi në orën 14:15

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni